

VENDIM
Nr. 632, datë 29.7.2020

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin (në vijim DPSHMZSH), si person juridik, publik, me status të veçantë, në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike (në vijim ministri), me seli në Tiranë.

2. DPSHMZSH-ja financohet nga buxheti i shtetit, si pjesë e buxhetit të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, të ardhurat nga shërbimi ndaj të tretëve, si dhe burime të tjera të ligjshme.

3. Misioni i DPSHMZSH-së, në cilësinë e autoritetit më të lartë teknik, mbikëqyrës dhe drejtues të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, është të garantojë shmangien e fillimit të një zjarri dhe ngjarjet që lidhen me të ose kufizimin e pasojave të tij apo fatkeqësive të tjera, nëpërmjet promovimit të rregullave, metodave të veprimit, monitorimit, koordinimit dhe trajnimit.

4. DPSHMZSH-ja ka këto përgjegjësi:

a) të organizojë punën për realizimin e funksioneve që lidhen me promovimin e rregullave, të metodave të veprimit, të monitorimit, të koordinimit;

b) të organizojë punën për realizimin e funksioneve që lidhen me kualifikimin dhe trajnimin e personelit të shërbimit vendor të MZSH-së, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të objekteve me rëndësi ekonomike dhe strategjike, dhe të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;

c) të organizojë punën për funksione që lidhen me inspektimin.

5. DPSHMZSH-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

6. DPSHMZSH-ja kryen detyrat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin apo legjislacion tjetër të lidhur me fushën e saj të përgjegjësisë dhe raporton e përgjigjet para ministrit.

7. DPSHMZSH-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili përfaqëson, organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit.

8. DPSHMZSH-ja, për realizimin e misionit të saj, ushtrimin e funksioneve dhe realizimin e detyrave bashkëpunon me kryetarin e bashkisë, si dhe me institucionet e tjera të administratës publike, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

9. Organika dhe struktura e DPSHMZSH-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

10. Statusi i punonjësit të DPSHMZSH-së rregullohet:

a) sipas ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, për punonjësit me grada;

b) sipas Kodit të Punës, për punonjësit administrativ;

c) sipas legjislacionit, për nëpunësin civil.

11. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të DPSHMZSH-së miratohet nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të DPSHMZSH-së.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ka stemën e saj, që përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet, “Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Vula e Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Për punonjësit aktual me grada të DPSHMZSH-së në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Brendshme, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Për nëpunësit civil aktual të DPSHMZSH-së në strukturën dhe organikën e Ministrisë së Brendshme, zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe